



Analizë e Projektligjit



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Cooperation Office Kosovo

MINISTRY OF FOREIGN AFFAIRS OF DENMARK

DANIDA | INTERNATIONAL
DEVELOPMENT COOPERATION

PROJEKTLIGJI PËR PRODUKTE TË NDËRTIMIT

Autor: Visar Ramaj

Editoi: Burim Ejupi dhe Dardan Abazi

“Ky botim është realizuar me përkrahjen e projektit Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) – i financuar nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë (SCO-K) dhe Ministria e Punëve të Jashtme e Danimarkës (DANIDA) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF). Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e Institutit për Politika Zhvillimore dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si qëndrim i SCO-K-së, DANIDA-së apo KCSF-së.”

I. HYRJE DHE PËRMBLEDHJE E ANALIZËS LIGJORE TË PROJEKTLIGJIT PËR PRODUKTET E NDËRTIMIT

Projektligji 06/L-333 për Produkte të Ndërtimit (Tutje referuar si Projektligji për Produkte të Ndërtimit) parasheh shfuqizimin e tërësishëm të strukturës ligjore aktuale për Produkte të Ndërtimit dhe zëvendësimin me një strukturë të re ligjore. Sipas arsytimit të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë së Republikës së Kosovës, në cilësinë e hartuesit dhe sponsoruesit të ligjit, kjo reformë është e domosdoshme duke marrë parasysh se struktura aktuale ligjore për Produkte të Ndërtimit ka dështuar të implementohet në praktikë, përmban standarde ligjore të paqarta, dhe në raste përmban edhe standarde ligjore kontradiktore në vetvete¹. Tutje, sipas Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, arsye tjetër me rëndësi për këto ndryshime ligjore është përafrimi me legjislacionin e BE-së dhe Rregulloren për Produkte të Ndërtimit Nr. 305/2011 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 9 Mars 2011².

Bazë për rregullimin e ri ligjor të Produkteve Ndërtimore dhe reformës në sektorin e ndërtimit, të pasqyruara në Projektligjin për Produktet e Ndërtimit, paraqet Rregullorja për Produkte të Ndërtimit Nr. 305/2011 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 9 Mars 2011 (Tutje referuar si “Rregullorja BE për Produkte të Ndërtimit”). Rregullorja BE për Produkte të Ndërtimit ka zëvendësuar Direktivën për Produkte të Ndërtimit 89/106/EEC (Tutje referuar si “Direktiva BE për Produkte të Ndërtimit”).

Projektligji për Produkte Ndërtimore, i bazuar në Rregulloren BE-së për Produkte Ndërtimore, parasheh avancimin e rregullativës ligjore në Kosovë në lidhje me produktet e ndërtimit, përgjegjësi më të lartë nga tërë aktorët në treg (prodhuesit, importuesit, distributorët), rritje e detyrimeve të raportimit dhe mbikqyrjes nga operatorët ekonomik, mbikqyrje shumë më të lartë nga ana e institucioneve përgjegjëse publike, dhe nivel shumë më të lartë të rregullativës teknike dhe harmonizimit. Si i tillë, rregullative e propozuar e re ligjore parashikon një zgjidhje shumë më komplekse ligjore, e cila kërkon resurse të konsiderueshme profesionale dhe institucionale për të realizuar.

Analiza e Projekt Ligjit për Produktet e Ndërtimit është bërë në duke e krahasuar dhe vlerësuar me Standardet Ligjore të Rregullores së BE-së për Produkte të Ndërtimit, praktikave më të mira rajonale dhe ndërkombëtare mbi standardizimin dhe certifikimin e produkteve ndërtimore, vlerësimit të kosotos ekonomike dhe ndikimit në çmimet e industrisë së ndërtimit, dhe përputhshmërisë me strukturat institucionale të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë për zbatimin e Projekt Ligjit.

¹Memorandimi Shpjeguesi Projekt Ligjit për Produktet e Ndërtimit, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, faqe 3, 4, 5, iqasshëm në http://ligjet.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/Documents/33memorandumishpjegues_shLJsUsjPb.pdf

² Ibid. faqe 5

Fillimisht, ndërmarrja e një reforme kaq substanciale për sektorin e ndërtimit, bazuar në një përvojë ku aplikimi i legjislacionit aktual ka dështuar, pa një analizë më të thellë të arsyeve të dështimit të strukturës ligjore aktuale dhe pa përfshirje substanciale të sektorit të ndërtimit, paraqet një faktor me rrezikshmëri të lartë të zbatimit e Projekt Ligjit për Produkte të Ndërtimit nëse zbatohet. Për më tepër, kjo reformë paraqet reformë substanciale ndikimi i së cilës shtrihet në industrinë e ndërtimit, e cila industri është faktori kryesor për rritjen e Bruto Produktit Vendor dhe është një ndër industritë me numrin më të madh të punësimit.

Vlerësimi i përgjithshëm i analizës ligjore është se Projekt - Ligji për Produktet e Ndërtimit, me përjashtim të Kapitullit IX, është në përputhje kërkesat Ligjore të Rregullores së BE-së për Produktet e Ndërtimit dhe paraqet praktikat më të zhvilluara dhe më të mira sa i përket trajtimit të Produkteve Ndërtimore. Rrjedhimisht, duke përcaktuar kushtet dhe përmbajtjen e Deklaratës së Performancës, shenjën CE dhe Shenjën e Konformitetit të Kosovës si parakushte për vendosjen e produkteve në treg, bazuar në publikimin e Standardeve të Harmonizuara të Kosovës në përputhje me Standardet e Harmonizuara Evropiane, Projekt Ligji për Produkte të Ndërtimit garanton sigurinë dhe cilësinë e produkteve ndërtimore në Kosovë.

Megjithatë, konkludimi i analizës është se projekt Ligji për Produktet e Ndërtimit ka rrezik serioz për dështimin e implemnetimit për shkak të a) standardeve të larta ligjore dhe të Harmonizimit të Standardeve teknike të kërkuar, b) kompleksitetit të lartë të Projekt Ligjit dhe dështimit të adresimit të më shumë se pesëmbëdhjetë (15) fushave kyqe, të cilat janë lënë të rregullohen përmes akteve nënligjore dhe c) parashikimi për ngritjen e disa institucioneve dhe trupave për implementimin e Projekt Ligjit, themelimi i të cilëve nuk është paraparë dhe lejuar me Deklaratën për vlerësimin e ndikimit financiar, e cila nuk parashikon ndarjen e mjeteve për këto kapacitete shtesë, dhe d) mungesës së kapaciteteve humane dhe dedikimit të resurseve për harmonizimin e standardeve të kërkuara.

II. ANALIZA EKONOMIKE E PROJEKTLIGJIT PËR PRODUKTE TË NDËRTIMIT DHE EFEKTI NË INDUSTRIJË E NDËRTIMIT

Projekt Ligji për Produkte të Ndërtimit ndikon në mënyrë direkte në tërë sektorin e ndërtimit, duke ngritur rregullativën ligjore mbi produktet e përdorura, duke rritur detyrimin e subjekteve ekonomike për raportim dhe për përshtatshmëri ligjore, dhe duke pasur ndikim direkt në koston e të bërit biznes.

Rrjedhimisht, Projekt-Ligji për Produktet e Ndërtimit paraqet reformë me rëndësi për sektorin e ndërtimit, me ndikim të drejtpërdrejtë në tërë strukturën ekonomike të Kosovës, në të cilën strukturë, sektori i ndërtimit paraqet një prej aktorëve kryesor. Pritjet janë se në rast të zbatimit të plotë të Projekt Ligjit për Produkte të Ndërtimit, do të ketë ngritje të cmimeve të produkteve ndërtimore, dhe rrjedhimisht edhe ngritje të cmimeve në industrinë e ndërtimit.

Sektori i ndërtimit vazhdon të jetë një ndër sektorët më të rëndësishëm dhe një potencial shumë i madh ekonomik për Kosovën, duke pasur parasysh nevojën për ndërtime të vendbanimeve të reja si dhe infrastrukturës rrugore. Sektori i ndërtimit shërben si një ndër shtyllat e ekonomisë së Kosovës, pamvarësisht të vështërsive në të cilat është duke kaluar, gjithë e më shumë është në rritje. Bruto Produktit Vendor (GDP) në vitin 2017 shënon një rritje reale për 4.4%, ku sektori i ndërtimit ka pasur ndikim prej 9.6% në rritje të Bruto Produktit Vendor³. Gjithashtu, me një pjesëmarrje prej 13.1% sektori i ndërtimit ishte punëdhënësi i dytë më i madh në Kosovë në vitin 2017, duke punësuar 47,200 veta⁴.

Indeksi i tërësishëm i Kostos të Ndërtimit në Kosovë (IKN) krahasuar TM4 2017 me TM4 2016, kishte ngritje me një mesatare prej 2.8%. Ngritja e indeksit, kryesisht u vërejt te kategoritë: transport (16.7%); materiale (3.5%); energji (4.0%); dhe kostot e tjera (0.7%). Ndërsa, kategoria e makinerisë kishte një rënie prej (-2.9%)⁵.

Ndërsa, indeksi i tërësishëm i Kosotos të Ndërtimit në Kosovë (IKN) krahasuar me vitin 2017 dhe 2016 kishte ngritje me një mesatare prej 1.8%. Pikërisht në këtë fushë, në rast të zbatimit të plotë të Projekt Ligjit për Ndërtim, mund të pritët rritje e indeksi të tërësishëm të Kostos së Ndërtimit në Kosovë.

³Agjencioni i Statistikave të Kosovës, Indeksi i Kostos të Ndërtimit TM4, 2017.

⁴Agjencioni i Statistikave të Kosovës, Rezultatet e Anketës së Fuqisë Punëtore në Kosovë 2017, Mars 2018.

⁵Agjencioni i Statistikave të Kosovës, Indeksi i Kostos të Ndërtimit TM4, 2017.

Tabela 1. Ndryshimet vjetore të indeksit të Kostos të ndërtimit, 2016-2017.

Viti	Periudha	Ndryshimet në përqindje
2016	Mesatarja vjetore	0.8
2017	Mesatarja vjetore	1.8

Burim: Agjencioni i Statistikave të Kosovës

Andaj, një prej analizave kryesore të cilat duhet të zhvillohen në lidhje me Projekt Ligjin për Produkte Ndërtimore është ndikimi në koston e ndërtimit dhe ndryshimeve të Kostos së ndërtimit. Kjo mund të realizohet vetëm përmes përfshirjes substanciale të industrisë së ndërtimit në procesin e hartimit dhe diskutimit të projekt-ligjit.

Egziston rreziku se me rritjen e rregullativës ligjore të testimit dhe certifikimit të produkteve ndërtimore, mund të ketë edhe rritje të koston së ndërtimit, apo edhe veprime nga ana e industrisë së ndërtimit në uljen e kostove tjera, duke përfshirë edhe punësimin.

III. RREGULLORJA BE PËR PRODUKTET NDËRTIMORE DHE SISTEMI I CERTIFIKIMIT CE NË BASHKIMIN EVROPIAN

Projektligji për Produkte Ndërtimore i Kosovës është i bazuar pjesërisht në Rregulloren e BE për Produkte Ndërtimore. Andaj, para se të bëhet vlerësimi i Projektligjit për Produkte Ndërtimore, është me rëndësi të bëhet një përshkrim i vetë Rregullores BE-së për Produkte Ndërtimore në të cilën vetë Projekt Ligji është i bazuar.

Rregullorja e BE për Produkte Ndërtimore ka si qëllim që të krijojë një strukturë të unifikuar dhe thejstuar ligjore në lidhje me produktet ndërtimore të cilat përdoren në kuadër të Bashkimit Evropian. Si e tillë, Rregullorja e BE-së për Produkte ndërtimore rregullon tri fusha kryesore: a) kërkesat për vendosjen në treg të produkteve ndërtimore, b) përcaktimin e kriterëve për vlerësimin e performancës së produkteve, dhe c) Përdorimi i CE shenjës së Konformitetit⁶.

Markimi me shenjën CE të konformitetit paraqet bazën kryesore për tregtimin e lirë të Produkteve Ndërtimore në kuadër të Bashkimit Evropian. Të gjitha Produktet Ndërtimore të cilat bartin shenjën CE përcaktojnë se një produkt i tillë është në përputhje me Standardet e Harmonizuara Evropiane, i plotëson kriteret për vlerësimin e performancës së produkteve, dhe se është i lirë për qarkullim në kuadër të tërë Bashkimit Evropian.

Të gjitha produktet ndërtimore të cilat bartin shenjën dhe markimin CE, mund të tregtohen dhe të përdoren lirshëm në të gjithë hapësirën e Bashkimit Evropian. Në lidhje me produktet të cilat janë të markuara me shenjën CE, asnjë shtet apo autoritet publik brenda Bashkimit Evropian nuk mund të kërkojë asnjë certifikatë apo testim shtesë të atij produkti. Për më tepër, markimi me shenjën CE dhe Deklarata e Performancës, përmbajnë edhe të gjitha informatat tjera në lidhje me produktin dhe përdorimin e tij, duke u mundësuar palëve të informohen në lidhje me përdorimin e materialeve të tilla.

Markimi me shenjën CE të konformitetit për produktet ndërtimore ndahet në dy grupe, grupi i parë i përfshinë produktet ndërtimore të cilat janë të obliguara të kenë shenjën e konformitetit CE, dhe grupi i produkteve ndërtimore të cilat e kanë opcionale markimin me shenjën e konformitetit CE.

Markimi me shenjën CE është i detyrueshëm në të gjitha rastet e egzistimit të Standardeve të Harmonizuara të Bashkimit Evropian të përgaditura nga trupat standardizues Evropian në përputhje me Direktivën 98/34/EC. Standardet e Harmonizuara shërbejnë për të përcaktuar metodat dhe dhe

⁶ Regulation (EU) No [305/2011](#) of the European Parliament and of the Council of 9 March 2011 laying down harmonised conditions for the marketing of construction products and repealing Council Directive 89/106/EEC, publikuar në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian dhe e qasshme në <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A32011R0305>

mënyrën e vlerësimit për produktet e ndërtimit. Ato i referohen qëllimit të përdorimit të produktit të mbuluar nga standardi, dhe përfshijën të dhënat teknike për produktin dhe mënyrën e vlerësimit për përmbushjen e të dhënave të tilla. Referencat për Standardet e harmonizuara publikohen në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian.

Në anën tjetër, markimi me shenjën CE mund të bëhet, edhe pse jo i detyrueshëm, edhe në rastin e mungesës së Standardeve të Harmonizuara nga ana e BE-së. Në një rast të tillë, prodhuesit mund të kërkojnë të pajisen me Dokumentin Evropian të Vlerësimit, të lëshuar nga Trupat e Vlerësimit Teknik, bazuar në Vlerësimin Teknik Evropian.

Bazuar në rregullat dhe standardet të cilat duhet plotësuar qoftë në kuadër të Standardeve të Harmonizuara në kuadër të Bashkimit Evropian, qoftë në kuadër të Vlerësimit Teknik Evropian, prodhuesi bënë përgaditjen e Deklaratës së Performancës së Produktit dhe në bazë të saj edhe vendosjen e markimit CE në produkt.

A. PËRMBAJTJA E CE MARKIMIT DHE DEKLARATËS SË PERFORMANCËS

Vendosja e shenjës CE në përputhje me Rregulloren e BE-së për Produktet e Ndërtimit lejon qarkullimin e lirë të produktet dhe dëshmon se produkti ndërtimor është në përputhje me performancën e deklaruar dhe se është vlerësuar sipas një Standardi të Harmonizuar Evropian (CE e detyrueshme) ose është lëshuar një Vlerësim Teknik Evropian (CE opcionale) për të.

Së bashku me Deklaratën e Përformancës, CE shenja e konformitetit do të ndihmoj klientët dhe përdoruesit e produktit për të kontrolluar përformancën e produktit dhe për të krahasuar me produktet tjera.

Deklarata e performancës në Bashkimin Evropian përfshin kodin e tipit të produktit, i cili duhet të identifikoj në mënyrë të qartë lidhjen midis produktit dhe përformancës, mund të jetë një numër, datë etj, e të cilat nuk duhet të jenë të njëjta për dy produkte. Po ashtu në deklaratën e përformancës identifikohet prodhuesi, përdorimi i parashikuar për produktin, sistemet e vlerësimit dhe verifikimit të qëndrueshmërisë (sistemi AVCP), standartet e harmonizuara, duke përfshirë edhe organet përgjegjëse, si dhe vlerësimin teknik Evropian. Vlerësimi dhe verifikimi i qëndrueshmërisë së performancës (AVCP) është një sistem i harmonizuar që përcakton se si të vlerësojë produktet dhe të kontrollojë qëndrueshmërinë e rezultateve të vlerësimit. Ky sistem mbron besueshmërinë dhe saktësinë e Deklaratës së Performancës.

IV. RREGULLATIVE LIGJORE AKTUALE NË LIDHJE ME PRODUKTET E NDËRTIMIT DHE NEVOJA PËR NDRYSHIM

Republika e Kosovës aktualisht ka në fuqi një rregullativë ligjore në lidhje me Produktet e ndërtimit. Kjo rregullativë ligjore përbëhet nga LIGJI Nr. 04/L-181 PËR PRODUKTET E NDËRTIMIT i vitit 2013⁷, i mbështetur nga Aktet Nënligjore/Rregulloret të cilat përfshijnë: Rregullore (MTI) - Nr. 07/2013 Për Miratimet Teknike Për Produktet E Ndërtimit, Rregullore (MTI) Nr.02/2014 Për Kërkesat Themelore Në Punët E Ndërtimit, Rregullore (MTI) Nr. 06/2014 Për Mënyrën E Vlerësimit Të Konformitetit Për Produktet Ndërtimore, Dhe Udhëzim Administrativ (MTI)- Nr.11/2014 Për Kushtet Për Subjektet Që Kryejnë Procedurat E Vlerësimit Të Konformitetit Për Produktet E Ndërtimit⁸.

Ministria e Tregtisë dhe e Industrisë, e vlerëson këtë rregullativë egzistuese ligjore si të paqartë, me standarde ligjore kontradiktore, rregullativë e cila ka dështuar të zbatohet në praktikë, dhe në shpërputhje me Legjislacionin e Bashkimit Evropian në këtë fushë⁹. Rrjedhimisht, edhe sygjerohet që e njëjta të shfuqizohet tërësisht me Projektligjin e Ri për Produktet Ndërtimore.

Përderisa konstatohet se Rregullative Aktuale ka dështuar të zbatohet në praktikë, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë nuk ofron asnjë analizë të detajuar mbi arsyet e një dështimi të tillë. Kjo sidomos duke qenë se Ligji Aktual për Produktet e Ndërtimit është hartuar në përputhje me Direktivën për Produkte të Ndërtimit 89/106/EEC, e cila ka përmbajtur standarde të pranueshme në lidhje me trajtimin e produkteve ndërtimore.

Nga dokumentet përcjellëse të Projekt Ligjit për Produkte Ndërtimore, është e qartë se arsye me rëndësi i ndryshimit dhe Shfuqizimit e Ligjit LIGJI Nr. 04/L-181 PËR PRODUKTET E NDËRTIMIT i vitit 2013, është harmonizimi i legjislacionit të Kosovës me acquis të BE-së, bazuar në Marrëveshjen e Stabilizim Asocimit dhe PKZMSA-së¹⁰, që ka përfshirë harmonizimin me Rregulloren e BE-së për Produkte të Ndërtimit. Rregulloren e BE-së për Produkte të Ndërtimit, e aprovuar në vitin 2011 dhe e cila ka hyrë në fuqi në vitin 2013, ka bërë zëvendësimin t Direktivës për Produktet e Ndërtimit.

⁷ I qasshëm në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në linkun <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8825>

⁸ Të gjithat e qasshëm në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në linkun <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8825>

⁹ Memorandimi Shpjeguesi Projekt Ligjit për Produktet e Ndërtimit, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, faqe 3, 4, 5, i qasshëm

në http://ligjet.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/Documents/33memorandumishpjegues_shLJsUsjPb.pdf

¹⁰ Opinioni Ligjori Përputhshmërisë me Legjislacionin e BE-së, Ministria e Integritetit dhe Evropiane, datë 11.04.2017, i qasshëm në

http://ligjet.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/Documents/33opinioniligjor_PYSUFkEUtu.pdf

Si përfundim, baza kryesore e fillimit të kësaj reforme është përafrimi me acquis të BE-së, më saktësisht me Rregulloren e BE-së për Produkte të Ndërtimit. Përkundër kësaj reforme, ky proces fillon nga dështimi në implementimin e Ligjit për Produkte të Ndërtimit, i cili gjithashtu ishte draftuar në përputhje me Direktivën e BE-së për Produkte të Ndërtimit, e për të cilin dështim nuk duket se ka një analizë të detajuar mbi dështimin dhe arsyet e dështimit të implementimit të ligjit.

V. PROJEKTLIGJIT PËR PRODUKTET E NDËRTIMIT - RREGULLIMI I RI LIGJOR I PROPOZUAR

Projekt-Ligji për Produktet e Ndërtimit përcakton kushtet për vendosjen apo vënien në dispozicion në treg të Kosovës të produkteve ndërtimore, dhe mënyrat se si dëshmohet përputhshmëria e produktit me kushtet e tilla. Si i tillë, është i ndarë në njëmbëdhjetë (11) kapituj dhe gjashtëdhjetë e tri (63) nene.

A. PRODUKTET E NDËRTIMIT TË LEJUARA PËR TU TREGTUAR NË TREGUN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Projekt Ligji për Produktet Ndërtimore përcakton kriteret për lejueshmërinë e një produkti ndërtimor të për tu plasuar në tregun e Kosovës, dhe përmes Nenit 1.2 dhe Nenin 2.2. sqaron se parakusht për vendosjen në treg, distribuimin dhe përdorimin e produkteve ndërtimore në Kosovë, produkti duhet të plotësoj konformitetin sipas një prej metodologjive:

- Shënimi me markën CE të konformitetit të Bashkimit Evropian, ose
- Përdorimi i shenjës së konformitetit të Kosovës
- Zbatimi i dispozitave tjera përpos atyre CE dhe shenja e konformitetit të Kosovës.

Projekt Ligji për Produkte Ndërtimore i barazon kriteret dhe nivelin e sigurisë dhe qëndrueshmërisë së produkteve të markuara me shenjën e konformitetit të Kosovës me produktet e Bashkimit Evropian të markuara me shenjën e konformitetit CE. Andaj, Shënimi me shenjën e konformitetit CE apo shenjën e konformitetit të Kosovës, e cila është e harmonizuar me standardet teknike Evropiane, sipas procedurave dhe kushteve të parashikuara në Projekt Ligj për Produktet e Ndërtimit, është garantues se produkti ndërtimor i përmbush kushtet e përcaktuara të cilësisë dhe sigurisë, dhe lirshëm mund të përdoret në çfarëdo pune ndërtimore.

Andaj, Pjesa kyqe e tërë Projektligjit për Produktet e Ndërtimit është Kapitulli II, i cili në mënyrë të detajuar e përshkruan Deklaratën e Performancës, shenjën CE dhe Shenjën e Konformitetit të Kosovës si parakushte për vendosjen e produkteve në treg. Në këtë mënyrë, kriteret për marrjen e shenjës së konformitetit të Kosovës barazohen me ato të Bashkimit Evropian.

Në një rën anë shenja e konformitet CE lëshohet në përputhje me legjislacionin e Bashkimit Evropian, Rregulloren e BE-së për Produkte të Ndërtimit, dhe paraqet sistem të zhvilluar i cili garanton cilësinë dhe sigurinë e produkteve të ndërtimit.

Në anën tjetër, Kapitulli II është i ndërlidhur në mënyrë organike me Kapitullin IV të ProjektLigjit për Ndërtim, parashikon se Agjencia Kosovare për Standardizim do të bëjë publikimin e Standardeve të Harmonizuara të Kosovës në përputhje me Standardet e Harmonizuara Evropiane. Gjithashtu, përmes këtij kapitulli përcaktohet se Ministria përmes akteve nënligjore do të bëjë përcaktimin e metodologjisë së Vlerësimin Teknik Kosovar, i cili duhet të jetë në përputhje me Vlerësimin Teknik Evropian.

Tutje, me kapitullin e III të përcaktohen detyrat dhe përgjegjësitë e të gjithë operatorëve ekonomik në lidhje me qarkullimin dhe përdorimin e produkteve ndërtimore, duke përfshirë prodhuesin, përfaqësuesin e autorizuar, importuesin, distributorin dhe të ngjashëm. Në këtë mënyrë definohet përgjegjësia e secilit operator në treg, nga prodhuesi e deri tek instalimi i atij produkti në punë ndërtimore.

Për më tepër, me Kapitullin VII të Projekt Ligjit për Produkte të Ndërtimit rregullohet Mbikqyrja e Tregut dhe klauzolat mbrojtëse, derisa me Kapitullin VIII i kalojnë përgjegjësitë Ministrisë për kalimin e akteve nënligjore për Mbikqyrjen dhe Zbatimin e Ligjit.

Përfundimisht, përmes Kapitullit IX, rregullohen produktet tjera të lejuara për tu tregtuar në Kosovë, e të cilat produkte nuk kanë as shenjën e konformitetit CE dhe as shenjën e Konformitetit të Kosovës. Ky paraqet një kapitull pak më problematik, dhe nuk e përcjellë metodologjinë dhe parimet e parashikuara me kapitullin II dhe IV.

Në këtë mënyrë, Projekt Ligji për Produkte Ndërtimore bënë trajtimin e plotë të produkteve ndërtimore, kjo në përputhje me Standardet e Rregullores së BE-së për Produkte të Ndërtimit.

B. STRUKTURA E REJA INSTITUCIONALE TË PARASHIKUARA ME PROJEKT-LIGJ

Për realizimin e qëllimeve të Projekt Ligjit për Produkte Ndërtimore, dhe sigurimit të zbatimit të të njëjtit, është parashikuar edhe ngritja e një Struktore komplekse të institucioneve dhe trupave publike.

Përmes Kapitullit VI të Ligjit, Nenet 29 - 45, përcaktohet se Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, në cilësinë e Autoritetit Emërues, do të bëjë përcaktimin e Trupave të pavarur të tretë në procesin e Vlerësimit dhe verifikimit të qëndrueshmërisë së performancës të produkteve të ndërtimit. Kjo

paraqet ngritjen dhe certifikimin e një strukture komplekse nga ana e Ministrisë, e cila strukturë do të jetë përgjegjëse në një prej aspekteve kyçe të konformitetit të produkteve në tregun e Kosovës.

Tutje, Me neni 13 Ministria merr përsipër që përmes një vendimi specifik të krijojë një institucion si “Pikë Kontakti”, dhe i cili do jetë përgjegjës për të ofruar informata për autoritetet e shteteve tjera dhe operatoirët ekonomik në lidhje me fusha si: rregulla teknike, kontakte, mjete juridike, dhe të gjitha informacionet tjera në lidhje me produktet e ndërtimit.

Për më tepër, Ministria merr kompetenca të gjëra me Kapitullin VII të ligjit për Arovimin e Akteve Nënligjore dhe për krijimin e organeve të vecanta dhe mbikqyrjen dhe implementimin e ligjit.

Megjithatë, rrezik serioz në implementimin e ligjit paraqet fakti se krijimi i këtyre trupave dhe institucioneve, të cilat janë esenciale për zbatimin e ligjit, nuk janë parashikuar me ndarjet e caktuara buxhetore.

VI. REKOMANDIMET PËR NDRYSHIME NË PROJEKT LIGJIN PËR PRODUKTET NDËRTIMIT

Analiza e Projekt Ligjit për Produktet e Ndërtimit është bërë në duke e krahasuar dhe vlerësuar me Standardet Ligjore të Rregullores së BE-së për Produkte të Ndërtimit, praktikave më të mira rajonale dhe ndërkombëtare mbi standardizimin dhe certifikimin e produkteve ndërtimore, vlerësimit të kosotos ekonomike dhe ndikimit në çmimet e industrisë së ndërtimit, dhe përputhshmërisë me strukturat institucionale të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë për qëllime të zbatimit.

Andaj, rekomandimet janë ndarë në dy grupe kryesore: a) Rekomandime strukturore mbi Projekt Ligjin për Produkte Ndërtimore, dhe b) Rekomandimet e Detajuara. Përmes rekomandimeve strukturore, jepen rekomandime të përgjithshme të cilat prekin substancën e një neni, kapitulli apo të një zgjidhje ligjore të rekomanduara me projektligj. Në anën tjetër, përmes rekomandimeve të detajuara, jepen rekomandime në lidhje me nene specifike dhe zgjidhje ligjore specifike.

A. REKOMANDIMET STRUKTURORE MBI PROJEKT-LIGJIN

- i. Kapitulli IX i Projekt Ligjit për Produktet e Ndërtimit nuk është në përputhje me parimet e përgjithshme dhe mënyrën e rregullimit të produkteve të ndërtimit

Kapitulli IX i Projekt Ligjit për Produkte Ndërtimore paraqet devijim nga standardi ligjor i vendosur në Projekt Ligjin për Produkte Ndërtimore se çfarëdo produkti i vendosur në tregun e Kosovës është në përputhje me Standardet e Harmonizuara Evropiane dhe Vlerësimin Teknik Evropian.

Duke shfrytëzuar paqartësinë dhe definimin shumë të gjerë të Kapitullit IX, më saktësisht Nenit 55 të Projekt Ligjit për Produktet e Ndërtimit, produktet e caktuara ndërtimore dhe kompanitë e ndryshme mund të shmangin dhe të bëjnë tërësisht të paaplikueshëm edhe Standardet Kosovare të Harmonizuara por edhe Standardet e Harmonizuara Evropiane, të cilat janë baza kryesore e tërë Projekt Ligjit për Produkte të Ndërtimit.

Si i tillë, Kapitulli IX nuk është në përputhje as me Rregulloren e BE-së për Produkte të Ndërtimit dhe as me parimet e Përgjithshme të Projekt Ligjit për Produkte Ndërtimore.

Përmes Kapitullit IX të Projekt Ligjit për Ndërtim, rregullohet dhe lejohet Vendosja në tregun e Kosovës së produkteve ndërtimore duke zbatuar dispozita tjera përveç atyre të kërkuara për shenjën CE apo shenjën e konformitetit të Kosovës. Përmes Nenit 55 shmangen në tërësi Standardet e Harmonizuara Evropiane, dhe kusht për lejimin e vendosjes së produktit në tregun e Kosovës e përcaktohet se është:

Natyra dhe/ose performanca e produkteve të tilla do të vlerësohet dhe deklarohet në përputhje me një nga pikat e mëposhtme:

- 2.1. një standard ndërkombëtar të përgatitur nga ISO ose IEC,*
- 2.2. një standard rajonal të një zone të tregtisë së lirë,*
- 2.3. një standard kombëtar të Kosovës,*
- 2.4. një standard kombëtar të ndonjë shteti tjetër,*
- 2.5. një skemë e pavarur për certifikimin e produktit të Kosovës ose ndonjë vendi tjetër, duke përfshirë produktet që janë në përputhshmëri me një vlerësim/ miratim teknik ose ekuivalent,*
- 2.6. testet, llogaritjet ose mjetet e tjera me të cilat mund të konstatohet përputhshmëria e produktit,*
- 2.7. përvoja e kaluar, përdorimi i kënaqshëm në një ndërtesë ose punime të tjera të ndërtimit, ku përvoja e tillë lejon njohjen e përshtatshmërisë së produktit.*

Kriteret e përcaktuara përmes Nenit 55 janë mjaft të paqarta dhe vështirë të matshme me kriteret objektive. Për më tepër, nuk përcaktohet asnjë institucion kompetent i cili është përgjegjës për vlerësimin e përshtatshmërisë së produkteve të tilla, duke përcaktuar vetëm se Ministria përmes Akteve nënligjore do të bëjë përcaktimin e një institucioni të tillë. E tërë kjo paqartësi dhe mos-përcaktim i institucioneve kompetente, është në kundërshtim me Rregulloren e BE-së për Produkte Ndërtimore dhe me metodologjinë dhe parimet në të cilat është ndërtuar Projekt - Ligji për Produkte Ndërtimore.

Si i tillë, Kapitulli IX për mënyrë alternative të vendosjes së produkteve në treg krijon paqartësi juridike, paqartësi institucionale për organet kompetente, dhe mund të jetë e dëmshme për kompanitë dhe produktet të cilat vendosin për certifikim me shenjën e konformitetit të Kosovës apo shenjën CE, të cilat janë procedura komplekse dhe rigorozë.

Rekomandim: Rekomandohet që të zhvillohen dy lloje të kriterëve dhe procedurave sipas Kapitullit IX për Produktet të cilat nuk bartin as shenjën e Konformitetit CE dhe as shenjën e konformitetit të Kosovës, dhe atë: a) Produktet e prodhuara në Kosovë, dhe b) Produktet e importuara nga shtete e treta. Për më tepër, duhet të dizajnohet një institucion ose organ specifik i cili do ketë kompetencë për të përcaktuar nëse një produkt mund të lejohet në qarkullim dhe përdorim në Kosovë në përputhje me Kapitullin IX.

- ii. Projektligji për Produkte Ndërtimore bazohet në numër të madh i akteve nënligjore për zbatim

Projektligji për Produktet e Ndërtimit varet tërësisht nga aprovimi i një numri të madh të akteve nënligjore për tu bërë i aplikueshëm dhe i zbatueshëm. Të gjitha kërkesat kyçe të ligjit janë lënë të përcaktohen përmes akteve nënligjore, të cilat efektivisht e kanë bërë të pamundur zbatimin e ligjit në formën aktuale pa aprovimin e akteve nënligjore të përcaktuara.

Në këtë mënyrë, janë më shumë se pesëmbëdhjetë (15) fusha kyçe që duhet të rregullohen me akte nënligjore, duke përfshirë: Pikat e Kontaktit për produkte ndërtimore, Kërkesat themelore për punimet e ndërtimit, kushtet për deklarimin e performancës së produktit të ndërtimit, themelimi i Vlerësimin Teknik Kosovar dhe Trupit për Vlerësim Teknik në Kosovë, Vlerësimi dhe verifikimi i qëndrueshmërisë së performancës së produkteve të ndërtimit, Sistemet e Vlerësimit të performancës dhe qëndrueshmërisë, Procedurat e thjeshtuara për Mikro Ndërmarrje, emërim dhe monitorimi për Trupat e Emëruar nga Ministria, Shfrytëzimi i hapësirave jashtë laboratorit testues nga trupi i emëruar. Për më tepër, me Nenin 50 dhe 51 Ministria merrë kompetenca të zgjeruara për të aprovuar akte nënligjore shtesë sipas nevojës.

Përderisa nuk është kontestuese që disa prej fushave janë me përmbajtje tërësisht teknike që është e nevojshme të adresohen përmes Akteve Nënligjore, shumë fusha tjera ka mundësi dhe duhet të adresohen përmes vetë Projekt Ligjit Aktual.

Sistemi i propozuar i zgjidhjeve të detajuara përmes akteve nënligjore rrezikon të sjellë vonesa të mëdha në zbatimin e ligjit, dhe situatë të mos-përputhjes në mes të teksteve ligjore dhe akteve nënligjore të cilat lënë hapësirë të madhe të funksionimit, të cilat edhe kanë qenë arsye e dështimit të zbatimit LIGJI Nr. 04/L-181 PËR PRODUKTET E NDËRTIMIT i vitit 2013.

Rekomandim: Projekt Ligji për Produkte të Ndërtimit duhet të rishikohet dhe fushat kyçe të cilat aktualisht parashikohet të zgjidhen përmes akteve nënligjore duhet të adresohen përmes tekstit të projekt-ligjit dhe duke kalkuluar edhe ndikimin buxhetor.

- iii. Projektligji për Ndërtim nuk ka një analizë të mirëfilltë financiare mbi kostot për zbatimin e ligjit dhe ngritjen e kapaciteteve institucionale

Për realizimin e qëllimeve të Projekt Ligjit për Produkte Ndërtimore, dhe sigurimit të zbatimit të të njejtit, është parashikuar edhe ngritja e një Strukture komplekse të institucioneve dhe trupave implementues. Për më tepër, edhe vetë Projekt Ligji për Produkte është kompleks dhe kërkon ekspertizë të lartë në çështjet në Standardizimit dhe Harmonizimin e Standardeve Teknike të cilat i adreson.

Ndër të tjera, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, në cilësinë e Autoritetit Emëruar, do të bëjë përcaktimin e Trupave të pavarur të tretë në procesin e Vlerësimit dhe verifikimit të qëndrueshmërisë së performancës të produkteve të ndërtimit dhe gjithashtu të krijojë një institucion si “Pikë Kontakti”, dhe i cili do jetë përgjegjës për të ofruar informata për autoritetet e shteteve tjera dhe operatorët ekonomik në lidhje me fusha si: rregulla teknike, kontakte, mjete juridike, dhe të gjitha informacionet tjera në lidhje me produktet e ndërtimit.

Përderisa këto dhe institucione tjera janë të parashikuara me Projekt Ligjin për Produktet Nërtimore, Deklarata për vlerësimin e ndikimit financiar nuk ka parashikuar kosto as për stafin shtesë, dhe as për aktivitetin e përcaktuara me ligj.

Si shembull, aktiviteti kryesor dhe më me rëndësi për zbatimin e Projekt Ligjit për Produkte Ndërtimore në Praktikë do të jetë përvetësimi i Standardeve të Harmonizuara Evropiane dhe Vlerësimin Teknik Evropian si Standarde të Harmonizuara të Kosovës dhe Vlerësimi Teknik i Kosovës. Në anën tjetër, asnjë ndarje buxhetore nuk është bërë në këtë drejtim. Në mungesë të Harmonizimit të Standardeve të Kosovës me ato të Bashkimit Evropian, i tërë ligji rrezikon të dështojë.

Rekomandimi: Rishikimi i Deklaratës së Vlerësimit e ndikimit Financiar dhe rishikimi buxhetor për alokimin e mjeteve të nevojshme për zbatimin e ligjit, duke përfshirë strukturën e re institucionale dhe aktivitetet e përvetësimit të Standardeve të Harmonizuara Evropiane.

- iv. Barazvlerësimi i kërkesave për shenjën e konformitetit CE me shenjën e konformitetit të Kosovës mund të jetë problematik në implementime Projekt Ligjit brenda afateve ligjore

Shenja e Konformitetit të Kosovës i nënshtrohet të njejtave standarde ligjore, kërkesave dhe specifikave sikurse shenja e Konformitetit CE e Bashkimit Evropian. Në këtë mënyrë, për lëshimin e shenjës së konformitetit të Kosovës kërkohet të dëshmohet përputhshmëria me Standardet Kosovare të Harmonizuara apo me Dokument të Vlerësimit të Kosovës bazuar në Vlerësimin Teknik Kosovar, dhe në rast se këto mungojnë me standardet Evropiane të Harmonizuara apo Standarde Teknike Evropiane.

Këtu janë dy probleme praktike të implementimit, egzistimi i kapaciteteve të mjaftueshme humane dhe profesionale për adoptimin e standardeve të tilla, dhe afati kohor i nevojshëm për arritjen e qëllimeve të tilla. Mungesa e kapaciteteve të operatorëve ekonomik në Kosovë në lidhje me përputhshmërinë me këto standarde, duke përfshirë sidomos prodhuesit, dhe mungesa e kapaciteteve të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë për të menaxhuar një proces kompleks të monitorimit të shenjave të konformitetit të Kosovës,

Në anën tjetër, Neni 63 i Projekt Ligjit për Produktet e NDërtimit parasheh se Ligji hyn në fuqi për një periudhë prej 90 ditëve prej ditës së Miratimit.

Një obligim i tillë substancial për Harmonizimin e Standardeve dhe të Dokumenteve të Vlerësimit Teknik, mund të ndikojnë në dështimin e zbatimit të ligjit.

Rekomandim: Kapitulli II dhe IV të cilët parashikojnë standarde të njëjta ligjore për lëshimin e shënjes së konformitetit të Kosovës me ato të Bashkimit Evropian, markimit me CE, në situatë kur Kosova nuk ka zhvilluar kapacitetet profesionale dhe teknike, e rrezikon zbatueshmërinë e tërësishme të ligjit. Duhet një analizë më e thellë për afatet kohore dhe kapacitetet për implementimin e ligjit.

- v. Kërkesat themelore për punime të ndërtimit duhet të jenë pjesë e tekstit integral të projektligjit për produkte ndërtimore

Bazë kryesore për Ligjin për Produktet Ndërtimore dhe hartimin e Specifikimeve Teknike të Harmonizuara të Kosovës janë Kërkesat Themelore për Punimet e Ndërtimit. Kërkesat Themelore për Punime të Ndërtimit përcaktojnë kushtet themelore për të gjitha punët ndërtimore, duke përfshirë kërkesat për rezistencën mekanike dhe stabilitetin, e deri tek konzervimi i energjisë dhe përdorimi i resurseve natyrale.

Sipas versionit aktual të Nenit 4, Kërkesat Themelore për Punimet e Ndërtimit do të rregullohen përmes një Akti nënligjor nga ana e Ministrisë dhe atë brenda një periudhe prej 6 (gjashtë muajve).

Rekomandohet që të ndryshohet kjo qasje, dhe Kërkesat Themelore për Punimet e Ndërtimit të jenë pjesë integrale e ligjit. Në përputhje me Nenin 3 të Rregullores BE për Produktet e Ndërtimit, ato duhet të jenë pjesë përbërëse e Ligjit, dhe janë bazë kryesore për hartimin e Specifikateve Teknike të Harmonizuara dhe Standardizimin.

Në përputhje me Rregulloren e BE-së për Produktet e Ndërtimit, parashihen shtatë (7) Kërkesa Themelore për Punimet e ndërtimit, e të cilat përfshijnë: 1. Rezistenca mekanike dhe stabiliteti 2. Siguria në rast të zjarrit, 3. Higjiena, shëndeti dhe ambienti, 4. Siguria dhe përdorimi 5. Mbrojtja nga zhurma 6. Kursimi i energjisë dhe izolimi i nxehtësisë, 7. Përdorimi i qëndrueshëm i materialeve ndërtimore.

Rekomandimi: Kërkesat Themelore për Punimet e Ndërtimit të jenë pjesë integrale e ligjit, duke marrë për bazë Aneksin I të Rregullores së BE-së për Produkte të Ndërtimit.

- vi. Trupat e Emëruar

Sipas përcaktimeve të Kapitullit VI, Ministria do të bëjë emërimin dhe publikimin e trupave të emëruar, të cilët do të jenë përgjegjës për në procesin e vlerësimit dhe verifikimit të qëndrueshmërisë së performancës së produkteve të ndërtimit.

Kjo është pjesa kyçe e cila lidhet me zbatimet e Projekt-Ligjit në Praktikë, andaj kërkohet një trajtim më i detajuar i institucioneve dhe kompanive të cilat mund të licencohet për të shërbyer si trupa të emëruar, palë të treta të cilat janë përgjegjëse për qëndrueshmërinë dhe performancën e produkteve.

B. REKOMANDIMET E DETAJUARA

Pjesa e dytë e rekomandimeve përfshinë rekomandime specifike në lidhje me Projektligjin për Produkte të Ndërtimit, duke u fokusuar në nene dhe zgjidhje specifike të sygjera me ligj. Në këtë drejtim, rekomandimet specifike janë të ndara në dy pjesë: rekomandimet mbi dispozita në konflikt të mundshëm me njëra tjetrën, dhe rekomandime për ridraftim të neneve specifike.

Nenet të cilat kërkojnë harmonizim më të lartë mes tyre, përfshijën Nenet në vazhdim:

Neni themelor me të cilin adresohet problemi	Neni i cili rregullon të njëjtën fushë	Paqartësia sa i përket standardit juridik	Zgjidhja e rekomanduar
<p>Neni 10, para 1</p> <p>“Përdorimi i shenjës së konformitetit të Kosovës mbetet opcional, përveç nëse një Vendim i marrë nga Ministria E bënë të detyrueshëm”</p>	<p>Neni 1.2 dhe Neni 2.2</p> <p>“Ky ligj përmban tri mënyra me të cilat produkti mund të tregoj përputhshmërinë me kërkesat e këtij ligji, si në vijim: 2.1. Përdorimi i shenjës CE; 2.2. Përdorimi i shenjës së konformitetit të Kosovës aplikohet në rastet kur prodhuesi përmbush kërkesat për vendosjen e saj, të përcaktuara në këtë ligj, apo shenjën tjetër ekuivalente të konformitetit sipas</p>	<p>Neni 10, paragrafi 1 krijon paqartësi juridike në lidhje me tërë aplikimin e Projekt-ligjit për Produkte Ndërtimit.</p> <p>Fushëveprimi i ligjit, neni 1 dhe 2, definojnë qartë se parakusht për përdorim në tregun e Kosovës është një prej tri opcioneve, ku një prej opcioneve është Vendosja e shenjës së konformitetit të Kosovës. Në anën tjetër, Neni 10, paragrafi 1 krijon paqartësi për mënyrën se si lirohet një</p>	<p>Duhet të aplikuar parimi ligjor se vendosja e produkteve ndërtimore në Kosovë i nënshtrohet njëerës nga tri kushtet bazike, sikurse parashikohet me Nenin 1 dhe 2 të Projekt-Ligjit. Neni 10 duhet të ridraftohet dhe të përmbajë këtë zgjidhje.</p>

	<p>marrëveshjeve të ratifikuara ndërkombëtare; 2.3. Vendosja në tregun e Kosovës së produkteve ndërtimore duke zbatuar dispozita tjera përveç atyre të kërkuara për shenjën CE apo shenjën e konformitetit të Kosovës</p>	<p>produkt nga obligimi për vendosjen e shenjës së konformitetit të Kosovës. Gjithashtu, nuk tregohet asnjë standard i lirit nga kjo përgjegjësi, sidomos në rastet kur produktit i mungojnë edhe dy certifikata tjera.</p>	
<p>Neni 30, paragrafi 1 dhe 2</p> <p>“Ministria do të jetë autoriteti emërues përgjegjës</p> <p>“Ministria mund të vendos që vlerësimi dhe monitorimi (por jo emërimi) i referuar nga paragrafi 1 do të kryhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit”</p>	<p>Neni 30, paragrafi 3</p> <p>“Nëse Ministria delegon ose i beson vlerësimin, emërimin, ose monitorimit një trup që nuk është entit qeveritar</p>	<p>Në paragrafin 30 krijohet paqartësi juridike në lidhje me autoritetin për emërimin e Trupit të Emëruar. Përderisa me paragrafin 1 dhe 2 ndalohet delegimi tek institucionet tjera, përmes paragrafit 3 të njejtit Nen lejohet ky delegim.</p> <p>Kjo krijon paqartësi në lidhje me një prej organeve kryesore të krijuara sipas ligjit, Trupat e Emëruar.</p>	<p>Duke qenë se Trupat e Emëruar paraqesin institucion me rëndësi në zbatimin e ligjit, rekomandohet që autoritet emërues të jetë vetëm Ministria.</p>

Në rast se vlerësohet dhe vazhdohet me këtë draft ligj, atëher ndryshimet e detajuara për fshijnë

Neni	Versioni Aktual	Versioni i sygjertuar për ndryshim
------	-----------------	------------------------------------

Neni 7 - Përmbajtja e Deklaratës së Performancës	Përmban në mënyrë të Detajuar përshkrimin se çfarë përmban deklarata e performancës	Në përputhje me metodologjinë e Rregullores së BE-së për Produkte të Ndërtimit, duhet bashkangjitur forma e caktuar e Deklaratës
Neni 8, paragrafi 5	Deklarata e Performancës duhet të jetë në gjuhët e kërkuara nga shteti ku produkti është vendosur	Kërkesë për Deklaratën e Performancës duhet të jetë gjuha shqipe dhe serbe si gjuhë zyrtare në Kosovë
Neni 9	Përshruan në mënyrë të detajuar përmbajtjen e CE shenjës dhe mënyrës së përdorimit në kuadër të Bashkimit Evropian.	Mund të thjeshtohet si Nen dhe të përcaktohet se shenja CE e lëshuar në përputhje me Rregulloren Nr. 305/2011 dhe Rregulloren 765/2008/EC njihet në mënyrë unilaterale në Kosovë.
Neni 36, paragrafi 1	... dhe verifikimi i qëndrueshmërisë së performancës 1+, 1 dhe 3	Neni duhet sqaruar dhe riformuluar për të shpejguar se nivelet e matjes së qëndrueshmërisë së performancës 1+, 1 dhe 3 e kanë bazën në Rregulloren e BE-së për Produkte të Ndërtimit.
Neni 47, paragrafi 1	Nëse një shtet tjetër, i cili është informuar në lidhje me masën e marrë nga Kosova, konsideron se masa e tillë është jo-proporcionale Ai mund të hyjë në konsultime me autoritetet e mbikqyrjes së tregut të Kosovës	Neni 47 duhet të riformulohet, dhe në përputhje me strukturën ligjore në fuqi në Kosovë, e cila nuk është anëtare e Bashkimit Evropian, duhet të kufizojë negociimin me shtete tjera. Masat juridike duhet të kufizohen sikurse parashihen në Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Konfliktin Administrativ.

“Kjo analizë është financuar nga projekti Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) – i financuar nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë (SCO-K) dhe Ministria e Punëve të Jashtme e Danimarkës (DANIDA) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF)”.